

V E N D I M
Nr. 157, datë 26.2.1998

**PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME NË DISA RRETHE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrethet Tropojë, Pukë, Peqin, Kurbin, Mallakastër, Gjirokastrë, Kolonjë dhe Sarandë, me qendër në këto qytete, hapen dhe fillojnë punën zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Veprimtaria e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethet Has, Malësi e Madhe dhe Delvinë të mbulohet përkatësisht nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve Kukës, Shkodër dhe Sarandë.

3. Për rrethet Fier, Berat, Korçë, Sarandë, Mallakastër, Shkodër dhe Kurbin, këshillat e rretheve, brenda muajit mars të vitit 1998, të sigurojnë mjediset e përshtatshme prej 300m² në dispozicion të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

4. Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme të marrin masa për transportimin, sistemimin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekave të këtyre rretheve pranë gjykatës së shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese dhe historike të tyre.

5. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve të kalojë brenda strukturës organizative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe kryeregjistruesit të pasurisë së paluajtshme.

Numri i punonjësve të hipotekave që kalojnë pranë këtyre 8 zyrave të regjistrimit është 9 veta.

6. Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të përcaktojnë në buxhetin e vitit 1998, mbulimin e shpenzimeve për financimin e veprimtarisë së zyrave të regjistrimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano